



## KONCEPTI

### HAKATON PËR TË DHËNA TË HAPURA

EDICIONI I TRETË

(24 – 27 mars, 2022)

#### Qëllimi i Hakatonit

Hakatonit është konkurs katër ditor në të cilin pjesëmarrësit duhet të krijojnë një zgjidhje kreative që do të mundësojë promovimin e konceptit të të dhënave të hapura. Qëllimi kryesor i Hakatonit është të sjellë të dhëna të hapura për qytetarët dhe t'i prezantojë ato në mënyrë të thjeshtë dhe inovative.

Produkti përfundimtar i Hakatonit pritet të jetë një zgjidhje kreative për vizualizimin e bazave të të dhënave, lidhjen e dy ose më shumë bazave të të dhënave ose lehtësimin e procesit të plotësimit dhe përditësimit të bazave të të dhënave në dispozicion të publikut, të publikuara nga një ose më shumë institucione publike. Ekipet mund të zgjedhin të zhvillojnë vetëm një nga konceptet e kërkuara ose të zhvillojnë zgjidhje integrale që përfshin dy ose tre elementë. Në bazë të kriterëve të përcaktuara do të zgjidhet vetëm njëra nga zgjidhjet e propozuara e cila do të renditet si më e larta.

#### Informacione të përgjithshme

Të drejtë të marrin pjesë në Hackathon kanë ekipet e studentëve ose start up-et e IT-së. Është thelbësore që anëtarët e secilit ekip të kenë njohuri mbi programim, dizajn, ekonomi, marketing dhe fusha të ngjashme.

Fituesi i Hakatonit do të marrë **3000 dollarë** mbështetje financiare **për të përfunduar versionin demo të një aplikacioni funksional.**

Bazat e të dhënave dhe regjistrat në dispozicion janë në formë të ndryshme dhe kanë mënyra të ndryshme botimi. Organizatori i Hakatonit nuk ka asnjë detyrim të paraqesë bazat e të dhënave në formë të përshtatshme për përpunim. Ekipet duhet të përpunojnë të dhënat në mënyrë të pavarur nëse ato nuk janë në formën e duhur. Koncepti që do të zhvillohet gjatë Hakatonit nuk ka pse të përmbajë të dhënat përkatëse, pra mund të bazohet në të dhëna të shpërndara në mënyrë të ngjashme që do t'i përgjigjen strukturës së bazës së të dhënave. Në rast se koncepti fitues bazohet në bazë të papërshtatshme për përpunim, do të sigurohet shtesë nga institucioni përkatës, për të zbatuar me sukses konceptin fitues.

## Regjistrimi i pjesëmarrësve

Të drejtë të marrin pjesë në Hackathon kanë ekipet e studentëve ose start up-et e IT-së. Është thelbësore që anëtarët e secilit ekip të kenë njohuri mbi programim, dizajn, ekonomi, marketing dhe fusha të ngjashme. Një ekip mund të përbëhet nga të paktën tre anëtarë dhe maksimumi tetë. Një kompani (\*start up/kompani fillestare) mund të regjistrojë vetëm një ekip.

*\*Kompani start up është një kompani që nuk është më e vjetër se 6 vjet, që ka ose është ende duke punuar në zhvillimin e një produkti ose shërbimi inovativ dhe është në një fazë të hershme investimi.*

Regjistrimi është në [vegëzën vijuese](#). Aplikimi është i hapur deri më **23 Mars 2022, deri në orën 12:00**.

## Rregulla

- Numri maksimal i ekipeve - pjesëmarrës në Hakaton është dhjetë (10);
- Një ekip mund të përbëhet nga të paktën tre anëtarë dhe maksimumi nga tetë;
- Një ndërmarrje (start-up kompani) mund të paraqet vetëm një ekip për pjesëmarrje;
- Ekipet punojnë me prezencë fizike në një vend të paracaktuar;
- Gjatë Hakatonit, ekipet do të marrin këshilla dhe mbështetje nga mentorët dhe organizatorët;
- Takimet me mentorët e Hakatonit do të organizohen dhe zhvillohen me prani fizike;
- Terminët e mentorimit përcaktohen nga mentorët dhe pjesëmarrësit zgjedhin një termin ose më shumë terminë sipas planit dhe preferencave të tyre;
- Funksionimi i kodit para ngjarjes me qëllimin e vetëm të përdorimit të kodit gjatë ngjarjes është në kundërshtim me rregullat dhe nuk lejohet;
- Ekipet duhet të ndalojnë me kodimin sapo të përfundojë Hakatoni (27 Mars ora 11:00). Prezantimi i produktit demo së bashku me lidhjen për të dërgohet në adresën e postës elektronike [hakaton@metamorphosis.org.mk](mailto:hakaton@metamorphosis.org.mk);
- Produkti demo duhet të përpilohet për kohëzgjatjen e Hakatonit;
- Produkti demo të jetë në gjuhën maqedonase.

## Koncept për lidhjen, prezantimin apo vizualizimin e bazave të të dhënave të publikuara nga institucionet publike

### Çfarë kërkohet?

Duhet të zhvillohet një aplikacion ueb/mobil që do të mundësojë vizualizimin, shfaqjen interaktive dhe/ose lehtësimin/digitalizimin e proceseve të plotësimit dhe përditësimit të të dhënave nga bazat e të dhënave të publikuara nga organet e administratës shtetërore. Lejohet bashkimi, kombinimi dhe lidhja e dy ose më shumë grupeve të të dhënave të lidhura.

Duhet të zhvillohet një aplikacion ueb/mobil që do të mundësojë shfaqjen e vazhdueshme të bazave të të dhënave që publikohen rregullisht nga organet e administratës shtetërore. Në 5 vitet e fundit qeveria ka publikuar mjete dhe baza të shumta të dhënash që janë vënë në dispozicion të publikut. Aktualisht

ekzistojnë mundësi të shumta për të përdorur të dhënat dhe për të krijuar baza të dhënash ose produkte të reja që do të përdoren për shfrytëzim më të mirë të dhënave në dispozicion publik. Në të njëjtën kohë, shumë baza të të dhënave publikohen si të dhëna të papërpunuara dhe publiku nuk sheh asnjë vlerë të shtuar nga publikimi i tyre. Qëllimi kryesor i aplikacionit duhet të jetë shfaqja e të dhënave që publikohen sot në formë tabelare dhe pa informacion shtesë. Në të njëjtën kohë, ka të dhëna që janë të ndërlidhura dhe duke i kombinuar ato mund të japin informacion shtesë që do të jetë në dobi dhe interes për qytetarët.

Ekipet mund të zgjedhin dhe kombinojnë grupe të dhënash nga ato të ofruara më poshtë ose të përpunojnë të dhëna sipas zgjedhjes së tyre. Përfshirja e gejmifikimit ose ndërveprimit të të dhënave do të konsiderohet si avantazh gjatë përzgjedhjes së zgjidhjes më të mirë.

Veç kësaj, ekipet që do të mundësojnë dhe ofrojnë zgjidhje inovative për plotësimin, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave më të thjeshta (që do të lehtësojnë ose digjitalizojnë praktikën aktuale), do të kenë përparësi në përzgjedhjen e zgjidhjes më të mirë. Prandaj, zgjidhja duhet të ketë dizajn të kuptueshëm dhe njëkohësisht back end të thjeshtë. p.sh. *Përdoruesi duhet të jetë në gjendje të qas të dhënat në mënyrë të thjeshtë, të jetë në gjendje të bëjë kërkime, krahasime ose llogaritje të ndryshme, dhe institucioni duhet të jetë në gjendje të vendosë dhe përditësojë të dhënat në format tabelor në mënyrë të thjeshtë ose të automatizuar, kurse sistemi t'i ngarkon, përpunon dhe shfaq në mënyrë të pavarur.*

Konceptet që do të shfaqin potencial për komercializimin ose përdorimin e të dhënave në dispozicion publik për të zgjidhur një problem të caktuar ose për të përmbushur nevojat e tregut do të kenë përparësi në përzgjedhjen e zgjidhjes më të mirë.

Nëse ekipi pjesëmarrës në Hakaton ka bazë të dhënash private që dëshiron ta kombinojë me grupe të dhënash publike, kjo do të konsiderohet si përparësi në përzgjedhjen e zgjidhjes më të mirë.

## Kriteret e vlerësimit

Çdo projekt demo gjatë Pitching-ut/Prezantimit të zgjidhjeve demo për aplikacionin përpara Komisionit për përzgjedhjen e një zgjidhjeje fituese vlerësohet individualisht nga secili anëtar i Komisionit, bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

### a. Pajtueshmëria me qëllimet e Hakatonit - 20%

Ky kriter vlerëson nivelin e përmbushjes së kriterëve të Hakatonit. Ideja duhet të ndjekë udhëzimet për promovim, afrim dhe thjeshtim të proceseve dhe mekanizmave për të dhëna të hapura.

### b. Realizueshmëria e zgjidhjes ideore - 20%

Ky kriter vlerëson nivelin e realizueshmërisë së zgjidhjes së ofruar. Ekipet që kanë një ide të qartë se si të zbatojnë konceptin duhet të kenë përparësi në vlerësimin e këtij kriteri..

### c. Prezantimi - 20%

Ky kriter vlerëson cilësinë e prezantimit, respektimin e kohës për prezantim, gatishmërinë e ekipit, koordinimin e tyre dhe përgjigjen e qartë ndaj pyetjeve të bëra nga anëtarët e komisionit.

### d. Shkalla e integritit - 15%

Ky kriter vlerëson karakteristikat teknike të konceptit, d.m.th. sa i thjeshtë është funksionimi, nëse ka zgjidhje për mënyrën e përditësimit të vazhdueshëm, nëse ka burim të dhënash të përcaktuar qartë dhe mundësi për lidhje me bazat e të dhënave ekzistuese. Nëse të dhënat janë në format që është i

papërshtatshëm për përpunim, atëherë koncepti duhet të ofrojë mënyrë për të siguruar vazhdimisht të dhënat përkatëse në një format të përshtatshëm.

**e. Kapaciteti i ekipit - 15%**

Ky kriter vlerëson gatishmërinë e ekipit për të zbatuar konceptin pas përfundimit të Hakatonit. Ekipi duhet të përbëhet nga anëtarë me aftësi dhe formime të ndryshme profesionale që janë plotësuese dhe kyçe për realizimin e suksesshëm të idesë.

**f. Inovacioni i idesë/zgjidhjes - 10%**

Ky kriter vlerëson shkallën e origjinalitetit të idesë. Është e nevojshme që ideja të jetë ndryshe nga ajo që ekziston aktualisht ose të ofrohet diçka e re që nuk ekziston fare në Maqedoninë e Veriut. Si inovacion konsiderohet gjithashtu edhe përmirësimi drastik i një zgjidhjeje që ekziston aktualisht, por ka mangësi.

**Numri total i pikëve: 100**

**Shkalla e vlerësimit:** nga 1 në 5 (ku 1 është më e ulëta dhe 5 është nota më e lartë)

Fituesi i Hakatonit është ekipi/zgjidhja demo që ka marrë më shumë pikë. Në rast të një numri të barabartë pikësh midis dy ose më shumë ekipeve, vota e mbajtësve të projektit është vendimtare.

## Pyetje dhe përgjigje

Pyetjet e juaja në lidhje me Hakatonin mund t'i dërgoni në [hakaton@metamorphosis.org.mk](mailto:hakaton@metamorphosis.org.mk); jo më vonë se 20 mars, 2022.

## Shembuj, regjistra dhe baza të të dhënave

Shembuj të portaleve nga vende të tjera:

World Health Organization (WHO) - Global Health Observatory data

[https://www.who.int/gho/maternal\\_health/reproductive\\_health/adolescent\\_fertility/en/](https://www.who.int/gho/maternal_health/reproductive_health/adolescent_fertility/en/)

Qeveria e Singaporit - Të dhënat demografike [https://data.gov.sg/dataset/resident-population-by-ethnicity-gender-and-age-group?resource\\_id=f9dbfc75-a2dc-42af-9f50-425e4107ae84](https://data.gov.sg/dataset/resident-population-by-ethnicity-gender-and-age-group?resource_id=f9dbfc75-a2dc-42af-9f50-425e4107ae84)

Transparency International

<https://www.transparency.org/gcb2013/country?country=afghanistan>

Gjeorgjia- <https://budgetmonitor.ge/en>

40 open data projects - <https://carto.com/blog/forty-brilliant-open-data-projects-preparing-smart-cities-2018/>

## Propozim të regjistrave:

- [www.data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-o6pa3obahne-n-hayka](http://www.data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-o6pa3obahne-n-hayka) - regjistër i të gjitha shkollave fillore në territorin e RMV. Ky regjistër mund të kombinohet me regjistra të tjerë në

dispozicion për publikun.

*- Financa*

- \* [www.finance.gov.mk/mk/igri](http://www.finance.gov.mk/mk/igri) - nuk ka regjistër të licencave të lëshuara për lojërat e fatit, por pasi të publikohen licencat e lëshuara, lehtë mund të zhvillohet një regjistër që mund të shfaqet në kombinim me regjistra të tjerë.
- \* <http://nbstat.nbrm.mk/pxweb/mk/> - Baza e të dhënave BPRMV e cila përmban të gjitha të dhënat e prodhuara nga Banka Popullore, por edhe të dhëna që nuk janë të dhëna të Bankës, por janë të lidhura me politikën monetare.

*- Shëndetësia*

- \* [www.data.gov.mk/organization/3dpabctbo](http://www.data.gov.mk/organization/3dpabctbo) - regjistrat në portalin e të dhënave të hapura
- \* [http://zdravstvo.gov.mk/sekundarna\\_i\\_tercierna/](http://zdravstvo.gov.mk/sekundarna_i_tercierna/) - regjistrat për institucionet shëndetësore në RMV
- \* <https://lekovi.zdravstvo.gov.mk/> - regjistrat që lidhen me barnat, farmacitë dhe ndihmat mjekësore

*- Mjedisi jetësor*

- \* [http://www.moepp.gov.mk/?page\\_id=2699](http://www.moepp.gov.mk/?page_id=2699) – regjistrat e mbajtur nga Ministria
- \* <http://data.gov.mk/organization/mxctttt> - regjistra shtesë, të publikuar në portalin e të dhënave të hapura

*- Bujqësia, pylltaria dhe menaxhimi i ujërave*

- \* <http://data.gov.mk/organization/mnhnctepctbo-3a-3emjodejictbo> – regjistra të publikuar në portalin e të dhënave të hapura
- \* <http://www.mzsv.gov.mk/> - regjistra shtesë të publikuar në ueb-faqen e Ministrisë (duhet të shkojnë te Regjistrat Aktivë në MBPSH)

*- Ekonomia*

- \* <http://data.gov.mk/organization/ekohomnja> – regjistra në portalin e të dhënave të hapura
- \* <http://www.economy.gov.mk/docs/registri> – regjistra të publikuar në faqen e internetit të Ministrisë

**Propozim baza:**

- [www.open.finance.gov.mk](http://www.open.finance.gov.mk) – Baza e të dhënave në të cilën mund të shihni të gjitha transaksionet që janë kryer dhe kaluar përmes Thesarit të Ministrisë së Financave. Baza e të dhënave përditësohet çdo 2 javë dhe përmban të dhëna të papërpunuara që mund të

përpunohen për qëllime kërkimore.

- [www.finance.gov.mk/mk/node/575](http://www.finance.gov.mk/mk/node/575) - Komplete të dhënash në lidhje me Buxhetin e RMV. Disa nga të dhënat janë në formatin XML i cili lejon përpunimin e tyre të mëtejshëm. Të dhënat e buxhetit janë përmbledhur në [www.budget.finance.gov.mk](http://www.budget.finance.gov.mk), ueb aplikacioni i Buxhetit Qytetar. Të dhënat buxhetore janë të dobishme në analizimin e politikave publike dhe fondeve të parashikuara për zbatimin e tyre në vitet aktuale dhe të kaluara.
- [www.finance.gov.mk/mk/node/898](http://www.finance.gov.mk/mk/node/898) – Të dhëna të lidhura me zbatimin e buxheteve të pushtetit qendror dhe vendor. Këto të dhëna mund të përdoren për kryqëzim me bazat e të dhënave të institucioneve dhe njësisve të tjera të vetëqeverisjes lokale.
- [www.e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home](http://www.e-nabavki.gov.mk/PublicAccess/Home.aspx#/home) – Ueb aplikacion që ofron një pasqyrë të plotë të prokurimeve publike të kaluara, të tashme dhe të ardhshme në të gjitha institucionet shtetërore. Baza e të dhënave nuk ka të dhëna të hapura dhe të gjitha kërkimet duhet të bëhen në mënyrë të pavarur ose duke ofruar qasje në informacionin publik. [www.opendata.mk/Home/Tekstualni?Category=2](http://www.opendata.mk/Home/Tekstualni?Category=2) – Portali që përpunon të dhënat në lidhje me prokurimin publik (baza e të dhënave e jashtme).
- [www.air.moepp.gov.mk](http://www.air.moepp.gov.mk) – Baza e të dhënave për stacionet matëse të cilësisë së ajrit e vendosur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- [www.data.gov.mk/organization/mbp](http://www.data.gov.mk/organization/mbp) - data.gov.mk është portal që përmban të gjitha të dhënat e hapura të institucioneve shtetërore, por më saktë është të kërkohet sipas organizatave. Kjo lidhje është paraparë për të dhënat e Ministrisë së Brendshme. Më shpesh, grupet e të dhënave grumbullohen dhe lidhen me sigurinë publike dhe sigurinë e trafikut.

### **Baza të të dhënave të propozuara nga sektori civil:**

- [www.opendata.mk](http://www.opendata.mk) – Baza e të dhënave e Qendrës për Komunikim Civil ka shumë të dhëna lidhur me financat publike. Shumica e të dhënave përpunohen nga Qendra.
- [www.mojvozduh.eu](http://www.mojvozduh.eu) – Baza Ajri im përbëhet nga të dhëna të lidhura me cilësinë e ajrit. Ekzistojnë gjithashtu baza të të dhënave brenda aplikacionit (<https://github.com/jovanovski/MojVozduhExports>) të cilat janë të lehta për t'u përpunuar dhe kanë vizualizim të disa të dhënave (<https://mojvozduh.eu/projects/crowdsour>